Ju lutemi mbani gati **numrin e siguracionit (karta jeshile e siguracionit/“e-card“)** dhe nëse të pajisur edhe fletën e mjekut për spital. Paraqituni në orar në ditën e shtrimit! (Nëse jeni pacient i kategorisë së veçantë, duhet të keni me vete dhe fletën e siguracionit tuaj shtesë dhe duhet të nënshkruani një formular obligimi).

Shpenzimet e qëndrimit në spital

Siguracioni juaj shëndetësor – me përjashtim të një pagese të vogël (Selbstbehalt) – mbulon të gjitha shpenzimet e qëndrimit tuaj në spital.

Pagesa që duhet të bëni ju**për persona të siguruar: 8,13 Euro në ditë**

por për maksimumin prej 28 ditëve për vit kalendarik – kjo do të thotë, që nëse ju keni me shumë se 28 ditë qëndrimi në spital për një vit kalendarik, nuk paguani për ditët e tjera.

Kjo pagesë nuk kryhet në rastin kur keni vendimin e sigurimeve shoqërore për mospagesë tarife ose kur jeni pacient i kategorisë së veçantë.

Pagesa juaj**për persona të siguruar nëpërmjet jush: ndërmjet 13 Euro dhe 14,40 Euro në ditë** (maksimumi për 28 ditë të vitit kalendarik).

Pagesa nuk kryhet në rastet e lindjeve.

Pagesa kryhet zakonisht ditën e daljes nga spitali. Nëse dalja nga spitali bëhet të shtunave, të dielave ose ditëve të festave, atëherë ju dërgohet fatura në adresën tuaj.

Ambulanca

Spitalet janë të pajisur dhe me sektorë të specializuar (p.sh. ambulanca e aksidenteve, ambulanca e otorinos, ambulanca dentare, ...), prej të cilave pas trajtimit përkatës mund të shkoni përsëri në shtëpi.

Edhe për kontrolltet pas daljes nga spitali duhet të drejtoheni përgjithësisht në ambulancë.

Është e mundshme, dhe që mjekja ose mjeku juaj t'ju dërgojnë për një vizitë të specializuar në ambulancën e spitalit.

Gjatë fundjave dhe ditë festash ambulancat e spitaleve qëndrojnë hapur (nuk kërkohet çertifikatë shëndetësore). Mbani gati për regjistrim numrin tuaj të siguracionit (kartën jeshile të sigurimit/"e-card").

4 NDIHMË PËR GJËNDJEN PSIQIKE DHE SHPIRTËRORE

Ndodhi të veçanta të rënda (humbja e vendit të punës, vdekja e njerëzve të afërm, vështirësi financiare, ndarja, ...) janë ndryshime rrënjësore në jetën tuaj dhe prishin balancën shpirtërore. Nëqoftëse jeni në dilemë dhe nuk dini më, se si do shkojnë punët më tej, ose keni ndjenjën, që çdo gjë e bëni gabim, atëherë mos ngurroni që të merrni ndihmë profesionale (psikologe/psikolog, psikiatre/psikiatër, psikologe/psikolog terapie).

Simptomat në gjëndje krizash psiqike e shpirtërore:

- ➔ izolim, humbje dëshire për gjithshka
- ➔ mënyra sjelljeje të pakëndshme, të paqarta
- ➔ mendime, të cilat nuk i shpjegoni dot, ose ndjenja, të cilat janë për ju të huaja, të panjohura ose që ndikojnë negativisht
- ➔ sjellje e acaruar agresive
- ➔ mbyllje e brendshme (e/i qetë, jo e/i interesuar)

Njerëzit e ambientit që ju rrethon, të cilët vuajnë nga kriza të tilla psiqike e shpirtërore, kanë nevojë për ndihmën tuaj. E rëndësishme është që të mos veprohet sikur problemet janë të padukshme, ndihma duhet të jetë aktive. Sjellja e duhur bën të mundur që të parandalohen edhe situata me pasoja shumë negative.

Si mund të ndihmoni ju?

- ➔ mos u tregoni indiferente/indiferentë; afrojuni këtyre personave në mënyre aktive
- ➔ konceptoni dhe afroni personin që ka nevojë për ndihmë
- ➔ përpiquni të vini veten në vendin e saj/tij, pa bërë vlerësime
- ➔ mos mbivlerësoni veten
- ➔ dëgjoni me vëmendje dhe vini kohë në dispozicion
- ➔ jepni pak këshilla, vetëm jini të pranishëm
- ➔ ndërmerri hapa aktive pa diskutime
- ➔ kërkonin me iniciativën tuaj ndihmë profesionale

(Burimi: *pro mente Oberösterreich*, Broshura „kur gjithshka shtohet shumë ...“)

! Ju lutemi kini parasysh:

Shënja të qëllimit të **vetëvrasjes**, të cilat bëhen nga vetë personi të qarta, duhet të merren në çdo rast seriozisht!

Organizoni në situata kritike ndihmë profesionale!

Tregoni kujdes për shëndetin tuaj psiqik e shpirtëror!

10 pikat e mëposhtëme mund t'ju ndihmojnë në këtë drejtim:

1. konceptoni vetëveten
2. flisni për këtë
3. qëndroni aktiv
4. mësohuni me eksperiencën e re
5. mbani kontakt me miqtë
6. kryeni diçka krijuese
7. merrni pjesë, mos qëndroni i mënjanuar
8. kërkoni ndihmë
9. çlodhuni
10. mos e lëshoni veten

(Burimi: *pro mente Oberösterreich, Broshura „kur gjithshka shtohet shumë...“*)

Në rastet urgjente:**➔ Urgjenca e Shërbimit Socialo-Psiqik/ Psychosozialer Notdienst**

Telefonatë urgjence në rastet e krizave psiqike
Figulystr. 32, 4020 Linz
Tel.: (0732)/651015

➔ Qendra e Ndërhyrjes në Gjëndje Krizash/Kriseninterventionszentrum

Qendër terapie për njerëzit me kriza psiqike
Hessenplatz 9, 4020 Linz
Tel.: (0732)/2177
E hënë deri e premte ora 8 - 19

➔ Ndhima Urgjencë Pastorale Shpirtërore/Notruf Telefonseelsorge 142**➔ Klinika e Sëmundjeve Nervore e Landit Wagner-Jauregg/Landesnervenklinik**

Wagner-Jauregg-Weg 15, 4020 Linz
Tel.: (0732)/6921-0

Konsultim dhe Shoqërim në Rastet e Krizave Psiqike**➔ Ambulanca multikulturale/****Klinika e Sëmundjeve Nervore e Landit Wagner-Jauregg**

Ofertë speciale trajtimi mjekësor me përkthyes/e për sëmundjet psiqike
akute ose të rënda (sipas orarit të rënë më parë dakort)
Wagner-Jauregg-Weg 15, 4020 Linz
Tel. (0732)/6921-26531
E martë ora 13 – 15, E premte ora 9 – 11

**➔ Qendra konsultore Socialo-Psiqike Linz-Qendër/
Psychosoziale Beratungsstelle Linz-Mitte, Pro mente**

Scharitzerstr. 16, 4020 Linz
Tel: (0732)/668238
e-mail: psb.linz.mitte@promenteoee.at

➔ **Qendra konsultore Socialo-Psiqike Linz-Jug/
Psychoziale Beratungsstelle Linz-Süd, Pro mente**

Wiener Str. 486, 4030 Linz

Tel: (0732)/318924

e-mail: psb.linz.sued@promenteooe.at

Zonja Mag.^a **Zarfina Helac** *Psikologe / Konsultë, terapi sociale në gjuhën bosnjake-kroate-serbe.*

➔ **Point, Qendër Konsultimi për Çeshtjet e Drogës/
Point, Beratungsstelle für Suchtfragen, Pro mente**

Starhembergstr. 11/2, 4020 Linz

Tel.: (0732)/770895-0 (ju lutemi për lënje orari)

Orari:

E hënë, E premte ora 10 – 16

E martë, E enjte ora 12 – 18

➔ **Qendra Socialo-Psiqike Linz-Urfahr/
Psychosoziales Zentrum Linz-Urfahr, Exit sozial**

Konsultë, Ndërhyrje në raste krizash, Terapi psiqike

Wildbergstr. 10a, 4040 Linz

Tel.: (0732)/719719 në çdo kohë

e-mail: psz.linz@exitsozial.at

➔ **Ambulanca Psiquatrike Sociale/Sozialpsychiatrische Ambulanz, Exit sozial**

Vizita neurologjike dhe terapi, konsultë mjekësore, terapi psiqike, përkujdesje nga një personel i diplomuar, ndihmë urgjencë psiquatrike, konsultë për të afërmit

Wildbergstr. 10a, 4040 Linz

Tel.: (0732)/700595

e-mail: ambulanz@exitsozial.at

Orari:

E hënë, E mërkurë ora 9 – 13

E martë, E enjte ora 14 – 18

E premte ora 9 – 15

- ➔ **Përkujdesje Mobile/Mobile Betreuung, Exit sozial**
Konsultë dhe shoqërim në banesë
Wildbergstr. 10a, 4040 Linz
Tel.: (0732)/716963
e-mail: mobet@exitsozial.at

- ➔ **Qendra e Migracionit për Migrantet dhe Migrantët OÖ/
migrares Zentrum für MigrantInnen OÖ**
Humboldtstr. 49, 4020 Linz
Zonja Sebiha Muslu, **Konsultore për jetën dhe temat sociale në gjuhë
turke dhe gjermane**
Lënja e orarit në këtë numër telefoni (0732)/667365-12


- ➔ **Ndihma dhe Përkujdesja për të Përndjekurit Politikë Austria e Sipërme/
Volkshilfe Flüchtlingsbetreuung Oberösterreich**
**OASIS Përkujdesje Psiqiko-Terapike për të Përndjekurit Politikë/
OASIS Psychotherapeutische Betreuung von Flüchtlingen**
Schillerstr. 34, 4020 Linz
Tel.: (0732)/603099
e-mail: therapieprojekt@volkshilfe-ooe.at

- ➔ **BILY, Qendër Konsultore për të Rinj, Familje dhe Çeshtje Seksuale/
BILY, Jugend- Familien und Sexualberatungsstelle**
Weißenwolfstr. 17a, 4020 Linz
Tel. (0732)/770497
e-mail: bily@cybertown.at
Orari
E hënë ora 15 – 18
E mërkurë ora 17 – 20
E enjte ora 12 – 15
dhe sipas rënjes dakort

- ➔ **Shoqata e Punës Profilaktike Shëndetësore/
PGA – Verein für Prophylaktische Gesundheitsarbeit**
Kaplanhofstr. 1, 4020 Linz
Terapi psiqike gratis
Kontakt telefonik dhe lënja orari në numrin e telefonit 0699/177771239 të
mërkurave ndërmjet orës 9 – 10

5 SHËRIMI ...

Medikamente, Receta



Receta

Nëqoftëse keni nevojë për mjekim medikamentoz, mjeku ju plotëson një **recetë** me medikamentet e duhuara. Këtë recetë (të plotësuar korrekt!) juve duhet ta paraqisni në farmaci, në bazë të saj ju jepen juve medikamentet përkatëse. Për çdo medikament të marrë me recetë ju nuk paguani çmimin e plotë të tij (i cili shpesh është shumë i lartë), pagesa që ju kryeni direkt në farmaci është një **tarifë recete mjekësore prej 4,45 Euro**.

Mospagesa e tarifës së recetës mjekësore:

Nëse të ardhurat tuaja neto në muaj nuk i tejkalojnë kufinj të e mëposhtëm, ju keni mundësinë të bëni një kërkesë në sigurimet shoqërore për të mos paguar tarifën e recetës:

€ 662,99 për persona që jetojnë vetëm
€ 1.030,23 për çiftë

(Për çdo fëmijë, që jeton me ju në të njëjtën banesë, ose kur vërtetoni shpenzime për arsye shëndetësore mbi mesataren, këto kufinj rriten.)

Aprovimi i medikamenteve

Disa medikamente me recetë ju jepen nga farmacia vetëm atëhere, pasi të jetë marrë nënshkrimi i shefit të shërbimit në siguracionin shëndetësor – mjekja ose mjeku juaj ju informojnë më hollësisht në këto raste. (Për medikamente të tilla, të cilat kërkojnë aprovim dhe që duhen marrë vazhdimisht, mund të lëshohen receta për një kohë të gjatë.)

Receta private:

Medikamente, recetat e të cilave i lëshon një mjek ose mjek privat, duhet të paguhen në fillim plotësisht vetë. Më pas mund të bëni kërkesën për kthimin e pagesës në siguracionin tuaj shëndetësor, duke bashkangjitur recetën dhe faturën e paguar.

❗ **Këshillë:** një recetë private mund ta paraqisni në siguracionin shëndetësor të Austrisë së Sipërme, i cili e konverton atë në një recetë normale – nëpërmjet kësaj nuk ju krijohen shpenzime shtesë – përveç tarifës normale të recetës për çdo medikament.

Produkte bimore

Mjekimet homeopatike janë të përfituara nga bimët, pra baza e përbërjes së tyre është vetëm bimore. Ato merren në farmaci si çdo medikament tjetër. Siguracioni shëndetësor merr përsipër shpenzimet për produkte homeopatike vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të shoqëruar me një vërtetim nga mjeku.

E rëndësishme për medikamentet:

Në farmaci shkruhet mbi çdo paketë sa tableta dhe sa herë në ditë duhet t'i merrni ato:

p.sh. „(1 / 1 / 2)“ do të thotë, që ju duhet të merrni një tabletë në mëngjes, një tabletë në drekë dhe dy tableta në darkë

ose „(1 / - / 1)“: një tabletë në mëngjes, në drekë nuk merrni tabletën, një tabletë në darkë

- ➔ Ju lutemi respektoni dozimin sipas mjekes ose mjekut tuaj të medikamenteve! Nëqoftëse një medikament ju jep veprime anësore, informoni sa më shpejt të jetë e mundur mjeken ose mjekun tuaj!
- ➔ Ju lutemi respektoni kohën e marrjes së medikamentit, siç e ka përcaktuar mjeku – marrja e medikamenteve nuk duhet të ndërpritet vetë!
- ➔ Disa medikamente duhen ruajtur në frigorifer – ju lutemi shikoni shënimin në kutinë e tyre!
- ➔ Në rastet kur ju jepen medikamente, të cilat duhen marrë për një kohë të gjatë, mos harroni të shkoni tek mjekja ose mjeku juaj në kohën e duhur për të marrë një recetë të re.
- ➔ Gjatë përdorimit të medikamenteve, të cilat i keni në shtëpi, kini gjithmonë kujdes për datën e skadencës, e cila është e shënuar në kuti!
- ➔ Medikamente, të cilat kanë skaduar, ju lutemi të mos i hidhni në plehërat e shtëpisë, por dorëzojini në farmaci!

Medikamente pa recetë

Ka mjekime, të cilat përdoren në rastet e sëmundjeve të lehta, kalimtare, të cilat ju mund t'i bleni pa recetë me çmimin përkatës së farmacistë (tableta kundër dhimbjeve, tableta kundër dhimbjeve të fytyrës, shurup kolle, ...).

Këshillohuni për to në farmaci!

Farmacitë në Linz



Farmacitë i gjeni ju kudo, ku shikoni këtë simbol

Adresat e farmacive, të cilat kryejnë **shërbim nate, fundjave** ose **ditë festash**, i gjeni në gazetatat aktuale ditore ose në tabelat e farmacive në afërsi të vendbanimit tuaj.

Informacion telefonik:

Samariterbund (0732)/2124

Rotes Kreuz (0732)/7644-0

Rettungsleitzentrale (0732)/2144

Në çdo farmaci mund të merrni ju planin e shërbimit të tyre.

Nëqoftëse ju bleni medikamente në farmacinë e rojës së natës, në fundjave ose në ditë festash, duhet të paguani një **shtesë** prej **1,20 Euro** (gjatë ditës) dhe **3,60 Euro** (gjatë natës ndërmjet orës 20 të mbrëmjes dhe asaj 6 të mëngjesit).

6 RUANI SHËNDETIN ...

Në Austri ju ofrohen mundësi të ndryshme, të cilat ju ndihmojnë juve të jeni të shëndetshëm dhe të ruani shëndetin tuaj.

Vizita profilaktike

Edhe kur e ndjeni veten të shëndetshëm duhet të jetë për ju i vetëkuptueshëm një kontroll mjekësor i rregullt i gjëndjes suaj shëndetësore. Shumë sëmundje, po të konstatohen në kohën e duhur, mund të mënjahohen ose shërohen më lehtë dhe më shpejt.

Nëqoftëse keni mbushur moshën 19 vjeçare, mund të kryeni gratis një herë në vit vizitën profilaktike (për të cilën nuk paguhet tarifa e çertifikatës mjekësore).

Programi bazë i vizitës profilaktike përmban:

- ➔ Analizë gjaku
- ➔ Analizë urine
- ➔ Analizë feçe për gjurmë gjaku (mbi moshën 40 vjeç)
- ➔ Bisedë për sëmundjet e deritanishme dhe shqetësimet aktuale
- ➔ Vizitë e përgjithshme e trupit (sikurse dhe gjoksi/prostata)
- ➔ Matje e tensionit të gjakut
- ➔ Biseda përfundimtare

Gjatë bisedës me mjekun ai ju vë në dijeni për përfundimet e vizitës dhe ju jep këshillat përkatëse, se si mund të reduktoni faktorët e dëmshëm për shëndetin tuaj dhe si mund të jetoni sa më shëndetshëm.

Vizita profilaktike speciale për gratë, e cila kryhet nga një mjeke gjinekologe ose mjek gjinekolog përbëhet ndër të tjera nga biseda për të konstatuar hershëm simptoma të mundshme të sëmundjes dhe marrja e analizës për diagnostikim bakteriologjik ose citologjik të membranave të organeve seksuale. Për gratë mbi moshën 40 vjeç kryhet gjithashtu një herë në vit një vizitë radiologjike e gjoksit („Mammographie“).

Kryeni vizitat profilaktike njëvjeçare! Për shembull në Siguracionin Shëndetësor të Austrisë së Sipërme/Oberösterreichischen Gebietskrankenkasse (OÖGKK):

➔ Vizita profilaktike

Gruberstr. 77, 4020 Linz

Regjistrimi: Tel.: (0732)/78 07-22 98

e-mail: vorsorgeuntersuchung@ooegkk.at

Konsultoret për prindërit dhe nënat

Për çështjet e shëndetit të foshnjës ose fëmijës suaj në moshë të vogël konsultoret e qytetit Linz ju ofrojnë në afërsi të vendbanimit tuaj **konsulta gratis** nëpërmjet një **mjeke pediatre** ose një **mjeku pediatër** për: ushqimin, përkujdesjen, vaksinimin

- ➔ **Am Bindermichl**, Am Bindermichl 66, 4020 Linz
Tel.: (0732)/344249
E premte ora 9 - 11.30
- ➔ **Auwiesen**, Allendeplatz 4, 4030 Linz
Tel.: (0732)/311742
E hënë ora 14.30 - 17, E enjte ora 9 - 11.30
- ➔ **Biesenfeld**, Dornacher Str. 7, 4040 Linz
Tel.: (0732)/243561
E hënë, E mërkurë ora 14 - 16.30, E premte ora 9 - 11.30
- ➔ **Ebelsberg-Ennsfeld**, Hofmannsthalweg 8, 4030 Linz
Tel.: (0732)/301056-18
E hënë, E premte ora 9 - 11.30, E mërkurë ora 14.30 - 17
- ➔ **Europastraße**, Europastr. 12, 4020 Linz
Tel.: (0732)/371375
E hënë ora 14.30 - 17
- ➔ **Franckstraße** (Dorfhalle), Franckstr. 68, 4020 Linz
Tel.: (0732)/654541-14
E mërkurë ora 14.30 - 17
- ➔ **Hertzstraße**, Hertzstr. 18, 4020 Linz
Tel.: (0732)/331406
E martë ora 14.30 - 17
- ➔ **Karl-Steiger-Straße**, Karl-Steiger-Str. 2, 4030 Linz
Tel.: (0732)/302071
E enjte ora 14 - 16.30
- ➔ **Landeskinderklinik**, Krankenhausstr. 26, 4020 Linz
Tel.: (0732)/6923-0
E enjte ora 9.30 - 11.30
- ➔ **Leonfeldner Straße**, Leonfeldner Str. 102a, 4040 Linz
Tel.: (0732)/731269
E mërkurë ora 14.30 - 17

- ➔ **Neues Rathaus**, Hauptstr. 1 – 5, 4041 Linz,
Eingang Fiedlerstraße
Tel.: (0732)/7070-2656
E enjte ora 14.30 - 17
- ➔ **Pichling**, Heliosallee 84, 4030 Linz
Tel.: (0732)/320071
E martë ora 14 - 16.30
- ➔ **Rohrmayrstraße**, Rohrmayrstr. 1, 4030 Linz
Tel.: (0732)/82008
E martë ora 14.30 - 17
- ➔ **Tegetthoffstraße**, Tegetthoffstr. 23, 4020 Linz
Tel.: (0732)/653568
E martë, E enjte ora 14.30 - 17
- ➔ **Zaunmüllerstraße**, Zaunmüllerstr. 4, 4020 Linz
Tel.: 0664/4745002
E martë ora 14.15 - 16.45

Vaksinat

Vaksinat janë mjeti mbrojtës më efektiv nga sëmundje të rezikshme – për shembull kundër Ixodidae/Zecken (meningiti i verës së hershme/FSME), paralizës fëminore, difterisë, fruthit-shytave-rubeolës, ... Një librezë vaksinimi është shumë efikase për të ndjekur planin e vaksinimit. Në raste sëmundjesh përbën ajo për mjeken ose mjekun përkatës një ndihmesë të madhe për konstatimin e mbrojtjes vaksinore në trupin e fëmijës.

Vaksina kundër Ixodidae/Zecke (FSME)

Nëpërmjet pickimit nga një Zecke mund të sëmureni nga meningiti i verës së hershme. Pasojat e kësaj sëmundje mund të shkaktojnë nga paralizat deri në vdekje. Mënyra e vetme efikase për parandalimin e një sëmundjeje të tillë është vaksinimi.

- ➔ është i mundshëm pas mbushjes së moshës 1 vjeç, vaksinimi bazë përbëhet nga 3 vakcina të pjesëshme
- ➔ Zgjatja e efektit mbrojtës së vaksinës: mesatarisht 3 vjet, më pas rekomandohet rifreskimi

Vaksina kundër Hepatitis A, Hepatitis B

Transmetimi i Hepatitis A-nëpërmjet viruseve nga: ujë i ndotur, lëngje ose kontakt të drejtpërdrejtë me të infektuarin.

- ➔ vaksinë e kombinuar (A+B)
nga Hepatitis A mbrojtja zgjat mesatarisht 10 vjet, nga Hepatitis B shumë vjet

Vaksina kundër Tetanus

Sporet e tetanus gjenden në gjithë botën në tokë dhe janë shumë rezistente. Nëpërmjet ndotjes këto spore mund të futen në trup.

- ➔ është i mundshëm pas moshës 7-vjeçare
 - 2 vakcina të pjesëshme me 4 javë ndërmjet, vakcina e tretë pas 6-12 muajsh
 - rifreskimi: çdo 10 vjet

Vaksina kundër Gripit

rekomandohet veçanërisht për njerëz në moshë mbi 60 vjeç dhe të sëmurë kronikë.

- ➔ vaksinë një herë në vit

(Përshkrimi „Vaksinat“ si vazhdim i broshurës „Ruajtja e shëndetit dhe si të mbrohemi nga sëmundjet“; Rotes Kreuz, 2003)

Fëmijët dhe të rinjtë janë më të rrezikuar nga sëmundjet, prandaj vaksinimi i tyre është shumë i rëndësishëm. Nëpërmjet vaksinimit në kohën e duhur jeni ju dhe familja juaj të shëndetshëm!

Shërbimi vaksinor i Zyrës së Shëndetit në Bashkinë e Qytetit Linz vaksinon kundër ...

- ➔ Difterisë, Tetanusit (sëmundje e plagëve)
- ➔ Pertussis (kollës së mirë)
- ➔ Haemophilus influenzae b (influcencës)
- ➔ Poliomyelitis (paralizës së fëmijëve)
- ➔ Fruthit-shytave-rubeolës
- ➔ Hepatitis B
- ➔ Ixodidae/Zecken (Meningitis së verës së hershme/FSME)
- ➔ Gripit

Këto vaksinime (me përjashtim të asaj të ixodidae dhe gripit) janë gratis për fëmijët deri në moshën 15-vjeçare. Për koston e vaksinave për të rritur informohuni ju lutem në Zyrën e Shëndetësisë.

Zyra e Shëndetësisë, Shërbimi Vaksinor/Gesundheitsamt der Stadt Linz, Impfservice

Neues Rathaus, Hauptstr. 1-5, 4041 Linz

Tel.: (0732)/7070-2631

e-mail: impfservice@mag.linz.at

E hënë – E premte: ora 7.30 - 12

E hënë dhe e enjte: ora 14 – 17

Mbrojtja nga AIDS

AIDS (dobësi e imunitetit) përbën një sëmundje ngjitëse, e cila shkaktohet nga një virus (HIV=virusi që dëmton imunitetin). I infektuar me HIV ose pozitiv-HIV do të thotë, që ekziston aftësia e transmetimit të virusit. Si pasojë e infeksionit dëmtohet sistemi imun. Kjo mund të zgjasë disa vjet. Gjatë kësaj kohe personi vetë nuk e ndjen që është i sëmurë, ndërkohë mund të transmetojë ai virusin në persona të tjerë. Në kohën e sotme është shërimi i AIDS i pamundur. Por nëse infeksioni konstatohet relativisht shpejt, ekziston mundësia që nëpërmjet marrjes së medikamenteve të mbrohet sistemi imun dhe sëmundja të pengohet ose parandalohet.

Transmetimi i infeksionit mund të ndodhë vetëm atëhere kur në trup hyn gjak i infektuar me virus ose sekrecione hormonale të organeve seksuale mashkullore dhe femërore të infektuara me virus (nëpërmjet plagëve të hapura ose marrëdhënjeve seksuale). Lëngje të tjera trupore (sekrecione orale, djersë) nuk përbëjnë rrezik për ngjitjen e sëmundjes. Mënyra më e përhapur e transmetimit të sëmundjes është marrëdhënja e pambrojtur seksuale. Prandaj përdorni për mbrojtje **preservativë!**

Gjithashtu një rrezik i madh për marrjen e virusit përbën përdorimi i së një njiëjtës shiringë dhe age injeksioni nga persona të ndryshëm (dependentë droge).

Kontakti nëpërmjet lëkurës, kontakti trupor si për shembull takim duarsh, përkëdhelje, ose kollitja, teshtima, përdorimi i përbashkët i enëve nuk përbëjnë rrezik për ngjitjen e virusit.

Nëqoftëse jepni **ndihmë të parë**, përdorni për mbrojtje gjatë trajtimit të plagëve me gjak **doreza për një përdorim** (mbahen me vete në makinë), të cilat pas përdorimit i zëvendësoni me të reja. Gjatë dhënjes së ndihmës nëpërmjet frymëmarrjes gojë-hundë (ose frymëmarrje gojë-gojë) përdorni si mbrojtje një **shami speciale** (vetëm për një përdorim)!

Nëpërmjet një „**Testi për AIDS**“, i cili mund të kryhet **gratis dhe anonim** pranë AIDS-Hilfe Oberösterreich, mund të diagnostikohet nëse jeni të infektuar me HIV ose jo. AIDS-Hilfe ofron dhe konsultë e përkujdesje, nëse testi rezulton pozitiv (=i infektuar me virusin e AIDS).

➔ Aidshilfe Oberösterreich

Langgasse 12, 4020 Linz

Tel.: (0732)/2170

e-mail: office@aidshilfe-ooe.at

E hënë ora 14 – 18, E mërkurë ora 16 – 20, E premte ora 10 –14

Lëvizja fizike

Lëvizja fizike është shumë e rëndësishme për shëndetin. Nuk është e domosdoshme të kryeni gjithmonë sport, edhe nëpërmjet punës fizike në kopësht (p.sh. kositje bari) arrihet forcimi i muskujve të caktuar. E rëndësishme është që gjatë ditës trupi të ketë lëvizje të mjaftueshme, të cilat mënjanojnë ngarjesën e njëanshme të tij. Lëvizja fizike të çlodh, të mban fit dhe nuk duhet të jetë patjetër me pagesë.

Disa lëvizje të rekomandueshme:

- mënjaroni ashensorin, përdorni shkallët
- shfrytëzoni edhe distanca të shkurtra, çdo lëvizje ka vlerën e saj
- për rrugë të shkurtra mënjaroni makinën
- shkoni me biçikletë në punë
- zgjidhni një lloj sporti, i cili ju sjell kënaqësi
- 3 x në javë të paktën 15 minuta shëtitje ose vrap
- në vendin e punës vazhdimisht dy minuta turrje dhe lirim të muskujve
- 10 minuta lëvizje fizike është më mirë se aspak!

Ushqimi

Marrja e një ushqimi të ekuilibruar është e rëndësishme për shëndetin tuaj. Trupi duhet furnizuar me të gjitha lëndët e domosdoshme ushqyese (proteina, yndyrna, koleidrate, vitamina, ...).

Nëpërmjet ushqimit optimal zvogëloni rrezikun e sëmundjeve. Nëqoftëse ju merrni ushqime shumë të yndyrshme, rritet rreziku i sëmundjeve si tension i lartë i gjakut (rrezik për infarkt zemre), të qarkullimi të gjakut, sëmundjeve reumatizmale, të shkëmbimit të lëndëve në trup (artroza, diabeti) ose kancer.

Është patjetër e domosdoshme që të mënjahohen në mënyre strikte ushqime të caktuara, por dhe të tjerat nuk duhet të konsumohen në sasi të mëdha. Edhe një përkufizim ushqime „të mira“ ose „të keqija“ nuk ndihmon shumë. Për një ushqim të shëndetshëm luan rol shumë të madh dozimi i drejtë dhe sasia, pavarësisht, nëse bëhet fjalë për yndyrna, kripë ose sheqer.

Nëqoftëse keni pyetje dhe paqartësi për temën „Ushqimi“, ju konsultojnë me kënaqësi bashkëpunëtorët e Zyrës së Shëndetit. Ju lutemi telefononi për lënjen e një orari!

➤ Zyra e Shëndetit e Qytetit Linz

Hauptstr. 1-5, 4041 Linz

Tel.: (0732)7070-2617

e-mail: gesundheitservice@mag.linz.at

Piramida e ushqimit

... poshtë konsumoni, sipër kurseni!

Të ëmblat dhe alkoholi

Konsumi i madh përforcon ose shkakton probleme të shëndetit.

Yndyrna, vajra, fruta me përmbajtje të lartë yndyre (arra, lajthi, bajame)

Transportojnë energji depozituese dhe shkatërrojnë shumë vitamina të tretshme në yndyrna. 1-2 lugë gjelle vaj (vaj sallate, vaj gatimi) mbulon nevojën ditore. Arrat, lajthitë, bajamet përmbajnë yndyrna të vlefshme, por dhe shumë kalori.

Mish, peshk, sallam, vezë

Përmbajnë shumë yndyrna dhe kolesterolin. Mish dhe pulë kufizoni në 2 deri 3 herë në javë! Peshku është një alternativë me më pak yndyrë përkundrejt mishit.

Qumësht, djathë, nënprodukte qumështi

Përmbajnë kalçium dhe proteina. Kini kujdes për sasinë e yndyrës – produkte me pak yndyrë nuk përmbajnë më pak kalçium, por më pak yndyrna dhe më pak kalori.

Perime, sallata, fruta

Përmbajnë shumë vitamina, lëndë minerale dhe lëndë koleidrate. 5 racione fruta/perime në ditë janë optimale. Vlerësoni frutat dhe perimet e stinës.

Buka, drithërat dhe frutat bishtajore

Buka dhe drithërat shërbejnë për energji, transportojnë proteina bimore, vitamina, lëndë minerale, koleidrate. Preferoni produkte të bukës së zezë. Frutat bishtajore (bizele, fasule) përmbajnë shumë proteina bimore.

Ujë, çaj, kafe

Pini çdo ditë 2 litra ujë të zakonshëm ose mineral pa i ëmbëlsuar/çajra mali ose frutash me pak ëmbëlsi. Mos përdorni për shuarjen e etjes: limonata dhe lëngje frutash. Jo më shumë se 2 filxhanë kafe, çaj të zi ose jeshil në ditë (kafeina thith lëngjet e trupit)!

(Burimi: Salzburger Gebietskrankenkasse, <http://esv.sgkk.at>)

Këshilla për një ushqim të shëndetshëm:

- vakte të rregullta
- çdo ditë fruta, perime, sallatë
- hani ngadalë dhe përtyponi mirë
- bukë të zezë, të lyer hollë me diçka me pak yndyrë
- ngopuni me perime; mishi vetëm për shije
- mos hani ndërmjet vakteve, megjithatë më mirë fruta se sa ëmbëlsira
- lëngje të shumta me pak kalori
- alkoholi nuk shuan etjen, ai përbën një pije që shijohet!

Pirja e duhanit

Në tymin e duhanit gjënden nikotinë, tarë, monoksid karboni si dhe substanca të tjera kimike të dëmshme. Pasoja të mundshme të pirjes së duhanit janë bronkiti kronik, sëmundje të zemrës dhe të enëve të qarkullimit të gjakut, të rrugëve të frymëmarrjes, të pjesës fundore të gjuhës ose dhe kancer i mushkërive.

Meqënëse nuk është gjithmonë e lehtë të heqësh dorë nga pirja e duhanit, ekziston mundësia për të marrë pjesë për shembull në seminarët gratis për lënjen e duhanit, të cilat i organizon siguracioni juaj shëndetësor. Për mundësi të tjera terapie për zëvendësimin e nikotinës (p.sh. ankerplast me nikotinë), mund të drejtoheni tek mjekja ose mjeku i familjes.

Dhëmbë të shëndetshëm

Karies është nga sëmundjet më të përhapura të dhëmbëve. Nëpërmjet kujdesit të duhur (higjiena e gojës, marrje e mjaftueshme e florit, ushqim i përshtatshëm, vizitë mjekësore në intervale të rregullta kohe tek dentistja ose dentisti) mund të parandalohen sëmundjet e mishit të dhëmbëve dhe të vetë dhëmbëve.

Për të ruajtur sa më gjatë dhëmbë të shëndetshëm, duhet të fillohet që në fëmijëri të kujdeset sa më shumë për pastrimin dhe mirëmbajtjen sa më të mirë të tyre dhe kjo edukatë duhet ndjekur me konsekuencë.

Ju mund të parandaloni karies, nëqoftëse ju ndiqni këshillat e mëposhtëme:

- më shumë perime, bukë, qumësht se sa snacks të butë dhe të ëmbël dhe Lëngje frutash
- pastroni dhëmbët 2 herë në ditë (pas buke, veçanërisht në darkë para se të flini)

7 ÇËSHTJE E GRAVE ...

Shtatzania



Sapo të kuptoni që jeni shtatzanë, duhet të shkoni rregullisht tek një gjinekologe ose gjinekolog. Atje ju pajiseni me një **pashaportë nënë-fëmijë/ Mutter-Kind-Pass**.

Me anë të saj ju jepet mundësia që të merrni pjesë në një **program vizitash gratis**, pra gjithë vizitat shëndetësore gjatë shtatzanisë si dhe gjatë vitit të parë të fëmijës janë për ju falas. Vetëm në këtë mënyrë mund të zbulohen dhe të kurohen në kohën e duhur sëmundje nga më të ndryshmet.

Pashaporta nënë-fëmijë lëshohet që në fillim të shtatzanisë.

Gjatë shtatzanisë parashikohen brenda afateve të caktuara 6 vizita gjinekologjike, 2 ekografi dhe një vizite e organeve të brendshme.

Për fëmijën tuaj janë parashikuar 9 vizita mjekësore, duke filluar në javën e parë direkt pas lindjes deri në vitin e 5-të të jetës.

Të gjitha vizitat tuaja regjistrohen nga mjeku përkatës në pashaportën tuaj nënë-fëmijë (gjinekolog, pediatër, patolog).

Ju lutemi vini re, që vizitat shëndetësore në shtatzani së bashku me vizitat e fëmijës deri në muajin e 14-të janë kushti, që juve t'ju aprovohet pagesa për përkujdesjen ndaj fëmijës edhe pasi fëmija të ketë mbushur moshën prej 21 muajsh!

Ku pajiseni me pashaportën nënë-fëmijë?

- ➔ tek gjinekologja ose gjinekologu
- ➔ tek mjekja ose mjeku juaj i shtëpisë
- ➔ në Zyrën e Shëndetit të Bashkisë Linz
- ➔ në të gjitha ambulancat e spitaleve, të cilat kanë dhe pavione lindjeje

Çertifikata mjekësore për të gjitha këto vizita është gratis!

Nuk duhet të harroni në asnjë mënyrë:

- ➔ Mbani gjithmonë me vete në interesin tuaj pashaportën nënë-fëmijë!
Në raste urgjente mund t'ju vihet shumë më shpejt në ndihmë.
- ➔ Kryeni gjithë vizitat mjekësore në kohën e duhur dhe tregoni kujdes që ato të jenë dokumentuara patjetër në pashaportën tuaj!
- ➔ Vizitat e detyrueshme mjekësore janë kushti që ju siguron tërheqjen e pagesës për përkujdesjen ndaj fëmijës.
- ➔ Gjatë shtatzanisë duhet të mënjanoni ngarkesën fizike!
- ➔ Nëqoftëse gjatë shtatzanisë jeni në marrëdhënje pune, nuk ju lejohet me ligj të punoni 8 javë para dhe 8 javë pas lindjes (periudha e mbrojtjes së nënës).

Kompensim nënë-fëmijë nga Land OÖ

Land OÖ aprovon një kompensim nënë-fëmijë prej 370 Euro (pagesa bëhet 2 herë nga 185 Euro).

Kusht për aprovimin e kësaj ndihme financiare është kryerja e vizitave të detyrueshme, të cilat janë të shënuara në „**fletoren profilaktike**“ („Vorsorgeheft“). Atë e gjeni tek mjeku i shtëpisë, i fëmijës ose tek mjeku i grave. (Nëqoftëse banoni në Linz, nuk ju nevojitet vërtetimi për banesën nga bashkia).

Ndihma gjatë shtatzanisë

➔ Kurs parapërgatitor për lindjen

Vizitoni, nëse është e mundur, një kurs parapërgatitor për lindjen! Atje mund të krijoni kontakte me gratë e tjera, të cilat si dhe ju presin një fëmijë, si dhe merrni këshilla të rëndësishme për periudhën e shtatzanisë, të lindjes dhe të kontaktit me foshnjën pas lindjes. Këto kurse i ofrojnë të gjitha spitalet me pavion gjinekologjik lindjeje, por edhe shumë gjinekologe dhe gjinekologë të ndryshëm, Volkshochschule Linz (VHS) dhe qendrat prindër-fëmijë. Merrni informacionin përkatës!

Konsulta për gratë shtatzëna

Nëqoftëse gjatë shtatzanisë keni nevojë për konsultë, atëhere drejtohuni tek adresat e mëposhtëme:

➔ Spitali i Përgjithshëm Linz/Allgemeines Krankenhaus der Stadt Linz

Pavioni gjinekologjik
Krankenhausstr. 9, 4020 Linz
Tel.: (0732)7806-0
E hënë – E premte ora 9 – 10
E martë – E enjt ora 14 – 15
(nëse e domosdoshme, ju vihet nga spitali në dispozicion një përkthyes-e)

➔ Instituti Konsultativ për Familjen dhe të Rinjtë i Qytetit Linz/ Institut für Familien- und Jugendberatung der Stadt Linz

Pfarrgasse 7, 4. Stock, 4020 Linz
Tel.: (0732)7070-1660
e-mail: inst.fjb@ajf.mag.linz.at
ju lutemi lini një orar
(nëse e domosdoshme, ju vihet në dispozicion një përkthyes-e)

➔ Zoe Konsultë për Gratë Shtatzëna/Zoe Schwangerschaftsberatung

Bürgerstr. 1, 4020 Linz
Tel.: (0732)778300
Internet: www.zoe.at; e-mail: office@zoe.at
E hënë – E enjte ora 8.30 bis 12 (Konsulta kryhet në orarin e rënë më parë dakort)

Kur lind fëmija ...

Lindja në spital

Ju mund të lindni në Linz në spitalet e mëposhtëme:

- Landes- Frauen- und Kinderklinik
- Allgemeines Krankenhaus der Stadt Linz
- Krankenhaus der Barmherzigen Brüder
- Diakonissen-Krankenhaus (siguracën privat i domosdoshëm!)

(të gjitha adresat dhe numrat e telefonit i gjeni në këtë broshurë në faqen 31)

Nëqoftëse vendosni se në cilin spital do të kryeni lindjen, krijoni menjëherë kontakt – që në muajt e parë të shtatzanisë!

Shfrytëzoni mundësinë për të parë që më parë pavionin dhe sallën e lindjes!

Përveç mundësisë për të lindur fëmijën në spital, ekziston alternativa e „**lindjes ambulante**“: juve dilni nga spitali 24 orë pas lindjes dhe jeni nën përkujdesjen e një mamie, e cila ju bën vizita shtëpie.

Nëse dëshironi të lindni në shtëpi („**lindje shtëpie**“), interesohuni sa më shpejt për një mami dhe kushtet që duhen plotësuar për lindjen:

- **Oö. Hebammengremium**
(Tel. 0676/ 6841844, Frau Spornbauer)

Vizita profilaktike gjinekologjike

Për të njohur dhe trajtuar sa më shpejt sëmundje të caktuara, është e rëndësishme, që t'i nënshtroheni një vizite gjinekologjike **çdo 6 muaj** tek një mjekë ose mjek për gratë (gjinekologe/gjinekolog).

Gjatë kësaj vizite ju merret dhe analiza për diagnostikim bakteriologjik ose citologjik të membranave të organeve seksuale për kancer si dhe ju vizitohet gjoksi.

Informacione të mëtejshme për temën shëndeti i gruas:

- ➔ **Qendra e Shëndetit të Gruas Linz/Linzer Frauen Gesundheitszentrum**
 Kaplanhofstr. 1, 4020 Linz
 Tel.: (0732)/774460
 e-mail: office@fgz-linz.at; Internet: www.fgz-linz.at
 Orari:
 E hënë, E enjte, E premte ora 9 – 12
 E martë ora 13 – 16; E mërkurë ora 15 – 19

Mbrojtja nga shtatzania dhe planifikimi familjar (jo vetëm çështje grash ...)

Për të parandaluar një shtatzani të paplanifikuar keni në dispozicion një sërë mënyrash mbrojtjeje.

Mënyra mbrojtëse • Për kë?	Siguria
Kapsula • grua	Mënyrë shumë e sigurtë, por efekte të pakëndëshme anësore të mundshme
Prezervativ • burrë	Mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga AIDS! Relativisht e sigurtë në aplikimet e rregullta
Sterilizimi • grua/burrë (Mbyllja e kanaleve vezore dhe spermatozoide)	Shumë e sigurtë, vetëm për çifte, të cilat nuk dëshirojnë më fëmijë
Injeksion hormonal • grua (4 herë në vit)	Shumë e sigurtë, vetëm për gratë në moshën mbi 40 vjeç dhe që nuk dëshirojnë më fëmijë
Spirale • grua	Relativisht e sigurtë
Suposte • grua	Shumë e pasigurtë!
Coitus Interruptus • burrë (Tërheqja e penisit përpara derdhjes së spermës)	Shumë e pasigurtë!
Mënyra kalendarike • grua	Shumë e pasigurtë!

(Vazhdim i broshurës „Ruajtja e shëndetit dhe si të mbrohemi nga sëmundjet“; Rotes Kreuz, 2003)

Konsultohuni me gjinekologun ose gjinekologun tuaj, se cila mënyrë është më efikase për ju.

Ndërprerja e shtatzanisë

Ndërprerja e shtatzanisë (aborti) është në Austri, pas konsultës me mjekun, e mundur përpara se të ketë mbaruar muaji i tretë i shtatzanisë.

Në Linz mund të kryhet aborti në spitalin e përgjithshëm të qytetit.

8 PERSONAT E PËRNDJEKUR PËR ARSYE POLITIKE

Në Austri ekziston që prej 1.5.2004 sistemi i „shërbimit bazë shëndetësor“ për të gjithë të huajt në nëvojë për mbrojtje dhe ndihmë (persona në pritje të azilit politik, me azil politik, persona të përzënë nga vendi i tyre pa mundësi kthimi dhe persona të tjerë të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të largohen nga autoritetet austriake). Nëpërmjet këtij shërbimi vihet në dispozicion një **siguracion shëndetësor**.

Për të kryer një vizitë mjekësore ose për të marrë medikamente, ju nevojitet dhe juve si të tjerëve një **certifikatë mjekësore**. Këtë mund ta merrni në çdo qendër të jashtme të OÖ Gebietskrankenkasse në Linz. (Ka raste që ajo lëshohet nga personi përgjegjës që ju ka marrë në banesë në patronazh.)

➔ Qendra Linz – Qendra kryesore

Gruberstraße 77, 4020 Linz
Tel.: (0732)/7807-0
e-mail: ooegkk@ooegkk.at
Orari
E hënë deri të enjte ora 6 - 17
E premte ora 6 - 15

➔ Qendra Linz Urfahr

Hauptstraße 16 – 18, 4040 Linz
Tel.: (0732)/710261
e-mail: urfah@ooegkk.at
Orari
E hënë – E premte ora 6.45
deri 15

➔ Qendra Linz Kleinmünchen

Zeppelinstraße 58, 4030 Linz
Tel.: (0732)/303741, 303742,
301899
e-mail: kleinmuenchen@ooegkk.at
Orari
E hënë – E premte ora 6.45 deri 15

Paraqisni gjithmonë kartën tuaj të siguracionit (karta jeshile/“e-card“). Kërkoni ndihmë nga personat përgjegjës në vendbanimin tuaj!

Si person i përndjekur politik, nuk paguani **tarifën e recetës** për medikamentet. Përveç kësaj ju nuk paguani dhe **tarifën ditore të përkujdesjes** në spitale.

9 PËR RASTE URGJENTE ...

Nëqoftëse lajmëroni për një rast aksidental, jepni pa tjetër të dhënat e mëposhtëme:

Ku ka ndodhur?

Çfarë ka ndodhur?


Sa është numri i të plagosurve/sëmurëve?

Çfarë lloj plagosjesh/sëmundjes janë?

NUMRAT E TELEFONIT PËR RASTE URGJENTE

*Urgjenca	144
*Zjarrfikësit	122
*Policia	133
Bashkimi vullnetar i samaritanëve	2124
*Urgjenca e mjekëve <i>(vetëm në fundjave prej të shtunës në mëngjes ora 7 deri në 7 të mëngjesit të ditës së parë të punës)</i>	141
Urgjenca e rasteve toksike	01/406 43 43
*Këshilla nëpërmjet linjës telefonike <i>(Konsultë për fëmijë dhe të rinj për probleme të çfarëdo lloji)</i>	147
*Helpline kundër dhunës ndaj grave	0800/222 555
Urgjencë për gratë e përdhunuara	(0732) 602200
Urgjenca sociale psikike	(0732) 651015
Qendra e ndërhyrjes në raste krizash	(0732) 2177
*Urgjencë telefonike anonime për probleme psikike-shpirtërore	142

**Nga këto numra telefonohet pa prefiks (kod), nga gjithë Austria, dhe gratis!*



Als ÖGB-
Mitglied
haben Sie die
echten
Vorteile auf
Ihrer Seite.

**Wer dabei ist,
ist besser dran!**

- >> Kollektivverträge
- >> Rechtsschutz
- >> Weiterbildung
- >> Sicherheitspaket
- >> Freizeit & Urlaub

ÖGB | Oberösterreich
www.gewerkschaft-ooe.at

LIWEST
Ein Kabel Alle Medien



**Direkt në
gjuhen time!**

Klientët e LIWEST-it e kanë këtë mundësi.

Sapee me paketen 24VISION ju vihen në dispozicion stacione TV-je në gjuhën tuaj
amëare. Çdo stacion me kualitet digital. Informacione të mëtejshme në numrin e
telefonit 0732 / 94 24 24.

**LIWEST Program i plotë me
KABËLL PER TV INTERNET | TELEFON**

www.liwest.at


Gold Palast
Uhren und Juwelen

Abgold & Bruchgold Ankauf & Umtausch
www.goldpalast.at
office@goldpalast.at

Wien GOLD PALAST
Schmidlgasse 2
1060 Hauptstadt
4020 Linz
TEL/FAX 0732/77 02 80

Wien ISTANBUL GOLD
Beldislermarkt 5
4020 Linz
TEL/FAX 0732/79 06 15

Wien ISTANBUL GOLD
Stadtplatz 13
4020 WNB
TEL/FAX 07242/21 04 44

**Për ne transfertat ekspres
ka një kuptim tjetër.**



DenizBank AG 
Partners e MoneyGram-it

4020 Linz Graben 16

1010 Wien Glinzer Ring 12
1040 Wien Wollzeile 5/1m 24/01 (Kabelhof)
1160 Wien Seitzergasse/Lehrstube 12
9310 Imbrück Museumstraße 23
9900 Regensburg Bismarckstraße 1-3

**MoneyGram, mënyra e shpejtë dhe
e sigurtë për të dërguar dhe për të
pranuar para në mbarë botën.**

- Transferta brenda 10 minutave*!
- Nuk nevojitet një llogari bankare!
- Mbi 75.000 pika shërbimi në më shumë se 170 vende!

Freephone (AUT):
0800 200 288/006 682 3688
www.moneygram.at

*Subject to receiving agent hours of operation
and local regulations.
TM & © 2005 Transwestern Business Company, Inc.
All rights reserved.

MoneyGram 
International Money Transfer



Diese Broschüre wurde gefördert von



Landesrat Josef Ackerl
Landesrätin Dr.ⁱⁿ Silvia Stöger

